



POLITIKA E PRIVATËSISË DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES SË INTERNETIT KUIK

- **I nderuar vizitor,**

Ju falenderojmë që po vizitoni faqen tonë të internetit. Privatësia juaj është shumë e rëndësishme për ne. Ky dokument përbën Politikën e Privatësisë dhe Kushtet e Përdorimit të kësaj faqeje interneti (“**Politika**”). Përmes vizitës në këtë faqe, ju konfirmoni se keni lexuar, bini dakord dhe pranoni parashikimet e kësaj Politike. Kjo faqe interneti (këtu e më tutje, “**Faqja**”) rregullohet nga ligji shqiptar. Kjo Politikë mund të ndryshojë dhe përditësohet në të ardhmen, megjithatë, në asnjë rast, nuk do të kufizojë të drejtat e garantuara nga ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Është përgjegjësia juaj të lexoni dhe të jeni në dijeni të versionit në fuqi të Politikës.

Kjo Faqe që po vizitoni, është faqja zyrtare e KUIK. Ajo ofron informacion mbi përdorimin e KUIK. KUIK është një shërbim transferimi fondesh elektronike.

KUIK i ofrohet përdoruesve në përputhje me kushtet përkatëse të përdorimit (“**Termet dhe Kushtet e Përgjithshme të KUIK**”).

Përmbajtja e kësaj Faqeje është e destinuar vetëm për qëllime informimi. Aksesimi në këtë Faqe është pa pagesë. Lidhjet me faqe të tjera të internetit, nëse ka, nuk nënkuptojnë miratim të këtyre faqeve apo përmbajtjes së tyre. Ju jeni përgjegjës për informacionin, opinionet dhe/ose rekomandimet e ofruara nga këto faqe të internetit të palëve të treta, dhe për t’u informuar mbi kushtet e privatësisë të këtyre faqeve të internetit.

Vizitorët e kësaj Faqeje mbeten anonimë. Ne nuk marrim apo mbledhim të dhëna personale apo sensitive përmes Faqes, pra ne nuk mbledhim informacion për identifikimin personal të personit tuaj. Ne mbledhim vetëm informacion të përgjithshëm mbi vizitorët, si: sa vizitorë kanë vizituar Faqen, apo cilët seksione të saj janë klikuar më tepër se të tjerët. Pra, ne mbledhim vetëm informacion standard lidhur me klikimet në seksionet e Faqes. Ky informacion mbledhet vetëm për qëllime statistikore dhe studimi (për të parë përjasjen e vizitorit, cilët seksione janë më interesante për vizitorët). Ne nuk (dhe nuk do të lejojmë palët e treta të) përdorim mjete statistikore, analitike për të ndjekur apo mbledhur informacion personal që i bën vizitorët e Faqes të identifikueshëm. Ne nuk lidhim të dhënat e mbledhura nga Faqja me asnjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çfarëdo burimi.

Të vetmet të dhëna që mund të shkëmbehen janë *email*-et dhe/ose emrat e individëve që zgjedhin të na kontaktojnë vullnetarisht. Të gjithë *email*-et janë fakultativë dhe dërgohen në adresat e specifikuar në Faqe. Kjo do të thotë që Faqja merr vetëm *email*-in dhe çdo kërkesë tjetër të dërguesit sipas nevojës, me qëllim që t’i përgjigjet kërkesës së dërguesit, që jepet vullnetarisht nga dërguesi.

Përmes kësaj Faqeje, ne nuk mbledhim apo ruajmë *cookies*. Asnjë *cookie* e asnjë lloji nuk përdoret për të ndjekur vizitorët e Faqes.



Shoqëria ka regjistruar emrin e *domain*-it www.kuik.al në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në përputhje me kuadrin ligjor përkatës në fuqi.

- **Pronësia Intelektuale**

Kjo Faqe konsiderohet si një e tërë dhe e pandashme. Informacioni i përmbajtur këtu është vetëm për përdorim personal. Nuk lejohet kopjimi apo transmetimi i tij. I gjithë informacioni i përmbajtur në seksionet e Faqes është pronë e Shoqërisë apo partnerëve të saj. Ndalohet rreptësisht kopjimi, shfaqja apo shpërndarja e këtij informacioni, në tërësi apo pjesëve të tij, përveç se për qëllime personale. Çdo mosrespektim i këtij rregulli përbën një shkelje dhe mund të sjellë ndëshkime civile dhe/ose penale. Është rreptësisht e ndaluar të përdoret apo kopjohet emri “KUİK” dhe/ose logo e tij, individualisht apo së bashku, për çfarëdo qëllimi, dhe në veçanti për qëllime reklamimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shoqërisë.

Shkarkimi apo kopjimi i informacionit nga Faqja nuk do të transferojë të drejtën e pronësisë mbi informacionin e sipërpërmendur. Ju nuk mund të kopjoni, tërësisht apo pjesërisht, transmetoni, elektronikisht apo me mjete të tjera, modifikoni apo përdorni Faqen për qëllime publike apo tregtare, apo të krijoni lidhje me këtë Faqe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shoqërisë. Të dhënat e paraqitura në këtë Faqe janë pronë ekskluzive e pronarëve të tyre përkatës.

- **Parashikime të Përgjithshme**

Pranimi i Politikës: Nëse nuk pajtoheni me këtë Politikë, ju lutemi të mos e përdorni këtë Faqe. Nëse e përdorni këtë Faqe, do të konsiderohet se keni rënë dakord me këtë Politikë. Ne rezervojmë të drejtën për të ndryshuar këtë Politikë pa njoftim paraprak duke e përditësuar atë te Faqja. Ju duhet ta vizitoni rregullisht këtë Faqe për të shqyrtuar Politikën në fuqi.

Si të na kontaktoni: Kjo Faqe i përket dhe operohet nga Shoqëria, me adresë në Njësia Administrative nr.5, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 1, Tiranë. Për çdo ankesë, pyetje apo korrespondencë të përgjithshme ju lutem kontaktoni në info@mpay.al.

Markat dhe e drejta e autorit: Kjo Faqe, përmbajtja dhe materialet e saj mbrohen nga të drejtat e autorit, të drejtat mbi markat tregtare, sekretet tregtare apo të drejta të tjera të pronësisë industriale apo intelektuale. Përdorimi i Faqes prej jush i nënshtrohet kësaj Politike. Modifikimi apo përdorimi i materialeve të kësaj Faqeje për qëllime që nuk lejohen nga kjo Politikë, mund të përbëjë një shkelje të të drejtave të autorit dhe/ose të drejtave të pronësisë industriale, dhe është i ndaluar. Ju mund të aksesoni dhe shfaqni materiale të kësaj Faqeje vetëm për qëllime personale apo jotregtare. Materialet e kësaj Faqeje nuk mund të kopjohen, riprodhohen, ripublikohen, ngarkohen, postohen, transmetohen, shpërndahen apo përdoren në asnjë mënyrë, përveç nëse kjo autorizohet specifikisht prej nesh. Përdorimi i materialeve në faqe interneti, aplikacione, shërbime apo media të tjera përveç se në Faqe është i ndaluar.

Ligji i zbatueshëm: Kjo Politikë do të qeveriset nga dhe do të interpretohet dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar. Nëse ndonjë nga parashikimet e këtushme rezultojnë në pazbatueshëm, i pavlefshëm apo kundër legjislacionit në fuqi, atëherë, parashikimi në fjalë do të konsiderohet i ndarë nga këta terma dhe nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e parashikimeve të mbetura.



Ne rezervojmë të drejtën për të ushtruar të drejtat e pronësisë mbi informacionin e publikuar në www.kuik.al. Kjo Faqe ofron të dhëna dhe informacion mbi përdorimin e KUİK. Për këtë arsye, ne autorizojmë vizitorët e Faqes të përdorin këtë informacion sipas nevojave të tyre, vetëm duke marrë parasysh dhe duke përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Ne rezervojmë të drejtën për të ndryshuar dhe përditësuar informacionin dhe të dhënat e publikuara në këtë Faqe. Në këta raste, vizitori duhet t'i referohet gjithmonë informacionit dhe të dhënave më të fundit;
- Ne nuk përgjigjemi dhe nuk jemi përgjegjës për asnjë dëm të asnjë lloji që mund të rezultojë nga përdorimi i informacionit të publikuar në këtë Faqe;
- Informacioni i publikuar në këtë Faqe (duke përfshirë logot, imazhet, njoftimet për shtyp, buletinet, dokumentet, etj.) është pronë e Shoqërisë.

Kjo Politikë hyn në fuqi me publikimin e saj në Faqe.